



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1897/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI108/20

Parashtrues

Luan Kazazi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Plm.nr. 76/2020 të 8 prillit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Luan Kazazi nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i parë i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020 të 8 prillit 2020.
3. Gjykata vëren se ky aktgjykim i njëjtë i Gjykatës Supreme gjithashtu është kontestuar në rastin KI110/20 ku parashtrues i kërkesës është Et-hem Bokshi.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesit të kërkesës, sipas pretendimeve të tij, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 korrik 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 14 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues në kërkesën e parë dhe Kolegjin shqyrtues në kërkesën e parë, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 21 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës, në përputhje me rregullin 40 (1) të Rregullores së punës, urdhëroi bashkimin e kërkesave KI108/20 dhe KI110/20, për faktin se si në kërkesën e parë, po ashtu edhe në kërkesën e dytë bëhet fjalë për procesin e njëjtë. Prandaj, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues në të dy rastet mbeten të njëjta si në kërkesën KI108/20.
9. Më 10 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave dhe në të njëjtën kohë kërkoi nga parashtruesit që të plotësojnë formularin zyrtar të kërkesës dhe t'i dorëzojnë në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u

zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH 108/20, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar anëtare e Kolegjit, duke përfshirë edhe rastin e tanishëm.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 30 gusht 2021, Gjykata, pasi nuk kishte përgjigje në shkresën e dërguar më parë më 10 gusht 2020, përsëri i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës duke e njoftuar atë për regjistrimin e kërkesës dhe përsëri i kërkoi atij të plotësojë formularin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
16. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj në asnjë nga shkresat që i dërgoi Gjykata. Ndërsa parashtruesi i kërkesës në rastin KI110/20 i ka dorëzuar Gjykatës dokumentet e kërkuara.
17. Më 7 tetor 2021, Gjykata vendosi, në pajtim me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës, që kërkesat KI108/20 dhe KI110/20 të shqyrtohen ndaras, si raste individuale, me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues.
18. Më 13 tetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës në rastet KI108/20 dhe KI110/20 dhe Gjykatën Supreme për ndarjen e kërkesave.
19. Më 3 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 11 prill 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) me Aktgjykimin (P. nr. 540/13) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor sepse gjatë vitit 2009, deri në maj 2011, në cilësinë e drejtorit dhe bashkëpronarit të subjektit NPT „Marigona“ SH.P.K. me qendër në Gjakovë, kishte shmangur raportimin dhe pagesën e tatimit për veprimtarinë në biznesin e NPT „Marigona“ SH.P.K., në atë mënyrë që nuk kishte treguar qarkullimin real që kishte në kuadër të veprimtarisë së tij afariste dhe në këtë mënyrë i kishte shkaktuar dëme Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ATK).
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 540/13) të 11 prillit 2019 *“për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
22. Më 12 nëntor 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin (PA 1. nr. 1265/2019) e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për mbrojtjen e ligjshmërisë *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal”*.
24. Më 10 mars 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me parashtruesin KMLP. II nr. 44/2020 propozoi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
25. Më 8 prill 2020, Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 76/2020 refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilën ai e parashtroi kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
27. Parashtruesi pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, konkretisht, *“Në procedurën e hetimeve që i kanë parapri Kallëzimit penal të ATK e edhe gjatë hetimeve nga ana e Prokurorisë së Shtetit, nuk është vepruar në kuptim të nenit 122, par. 2 dhe 132 par. 5.7 të KPPRK, paragrafi 5 të KPPRK, veprimi i tillë paraqet arbitraritet dhe këtë gjykim e bënë jo të drejtë dhe jo korrekt,*

përkatësisht veprimi i tillë paraqet shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ (e drejta për një proces të rregullt).

28. Sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, parashtuesi i kërkesës këtë shkelje e ndërlidh edhe me shkeljen e parimit *Ne bis in idem*, konkretisht për dy arsye: a) Në nenin 69 parashihet që kohëzgjatja e hetimit të veprave penale në fushën e tatimeve për përfundimin e hetimeve ndaj veprës penale tatimore është **një vit** me mundësi të zgjatjes së mëtutjeshme të kohës së tillë shtesë të nevojshme dhe e justifikuar me ndërlikueshmërinë e rastit me vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Në këtë çështje nuk është kontestuese se nuk është paraqitur kërkesë për zgjatje të afatit për hetime dhe meqë hetimet kanë zgjatur më gjatë se një vit, sipas cilës do aktakuzë. Kjo dispozite përveç që është **lex specialis** për vepra penale tatimore është edhe më e favorshme për të pandehurin dhe kjo duhet aplikuar. **Në bazë të cekurave, hetimi duhej pushuar - neni 159 par. 1. i KPPRK dhe** b) Shkelje tjetër në bazën *ne bis in idem* qëndron në faktin se pranë ATK është zhvilluar procedurë ndëshkimore në bazë të dispozitave ndëshkimore të Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës [...] Bazuar në parregullsitë e konstatuara gjatë kontrollit në objektin afarist „N.T.P. „B-Marigona“ me NRF 600204292, është lëshuar ndëshkimi në vlerë 1.000,00 € sipas Ligjit 03/L-222, neni 53 paragrafi 2.4. [...] Kontrollët e ATK-së, argumentohet se ATK ka konsideruar një dënim-gjobë, përkatësisht sanksion, dhe nga ana tjetër argumenton se procedurat penale duhet të zhvillohen në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.
29. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, por të njëjtin nuk e arsyeton apo shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni.
30. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që, “Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Plm. nr. 76/2020 dt. 08.04.2020, Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1. nr. 1265/2019 dt. të 12.11.2019 dhe atë të Gjykatës Themelore në Gjakovë P. nr. 540/13, datë 1.04.2019 të shpallë - deklaron kundër kushtetues”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat tjera të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

34. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kërkesat kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore nga një “autoritet publik”, pasi i kanë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kusht përcaktohet edhe në nenin 47 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit posaçërisht i obligon parashtruesit e kërkesës të theksojnë qartë aktin konkret të autoritetit publik të cilin ata e kontestojnë. I njëjti nen gjithashtu i obligon parashtruesit e kërkesës të tregojnë qartë se cilat të drejta dhe liri ata pretendojnë se u janë shkelur.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:
- “ Nëse kërkesa [...] nuk është [...] e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...]”.*
37. Gjykata më tej i referohet rregullit 32 (2) (h) [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

38. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

[...]

(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.

39. Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit e ka pranuar më 7 korrik 2020. Duke qenë se kërkesa nuk ishte plotësuar, më 10 gusht 2020, në pajtim me paragrafin 4, të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të plotësojë kërkesën e tij, përkatësisht formularin e kërkesës zyrtare brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimin të shkresës së parë. Gjykata vëren se më 12 gusht 2020, parashtruesi pranoi shkresën e parë të Gjykatës për të plotësuar formularin, por ai nuk iu përgjigj kërkesave të saj. Prandaj, më 30 gusht 2021, Gjykata përsëri iu drejtua parashtruesit me kërkesën për të dorëzuar formularin zyrtar të kërkesës. Gjykata vëren se më 1 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës pranoi shkresën e dytë nga Gjykata, por përsëri nuk iu përgjigj kërkesave të Gjykatës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën,”.

[...]

41. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit të kërkesës dy herë me një kërkesë të tillë, por pa sukses.
42. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është e paplotë në kuptimin që parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur Gjykatës në kërkesën

për plotësimin e parashtrësës së tij që Gjykata e kishte kërkuar me shkresën e 10 gushtit 2020 dhe me shkresën e 30 gushtit 2021.

43. Gjykata vëren se shkresat e njëjta i ishin dërguar edhe parashtruesit të kërkesës në rastin KI110/20 i cili konteston aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj në asnjë nga shkresat që i dërgoi Gjykata. Ndërsa parashtruesi i kërkesës në rastin KI110/20 i ka dorëzuar Gjykatës dokumentet e kërkuara
44. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
45. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/17, me parashtruese *Sladana Radojković-Marinković*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21; dhe KI74/18, me parashtrues *Gëzim Murati*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26).
46. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 3 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka Nimani